

George Plouze
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI



AMENDAMENT

**PËR NJË SHITESË NË PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHITESA DHE
NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E
SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, deputetja Znj. Jorida Tabaku propozon,

Në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Neni 1

Pas pikës 10, të nenit 49, shtohet pika 11 me përmbajtje si më poshtë vijon:

11. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e mallrave të shportës, është në nivelin 6 për qind. Mallrat e shportës do të konsiderohen mielli, buka, vezët, qumështi, bulmeti, patatja, vaji, sheqeri dhe mishi.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN

PËR NJË SHITESË NË PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHITUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I AMENDAMENTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Amendamenti synon uljen e TVSH-së për shportën bazë të ushqimeve nga 20% në 6%. Kjo ulje e TVSH-së synon që të ndihmojë qytetarët shqiptarë, në përballimin e vështirësive financiare dhe rritjen e të ardhurave personale, si rezultat i uljes së TVSH-së.

Ulja e TVSh-së synon që të mbrojë portofolin e qytetarëve nga rritja e çmimeve të shportës së ushqimeve si dhe nga kriza e inflacionit që ka goditur vendin.

Nëpërmjet uljes së TVSH-së për ushqimet e shportës bazë, garantohet një frenim i thellimit të krizës ekonomike familjare dhe varfërimit të popullsisë. Gjithashtu synohet që kjo masë të ndihmojë edhe familjet shqiptare për të përballuar rritjen e normave të interest në banka, kostot e kredisë, kostot e rritura të jetesës.

Shumë vende të Rajonit, por edhe të Bashkimit European janë duke aplikuar Programe Sociale, me reduktim të TVSH-së për shportën bazë të ushqimit, në mënyrë për të lehtësuar jetesën dhe përballuar rritjen e çmimeve.

Kjo nismë synon gjithashtu arritjen e dy objektivave: (i) ulje e cmimit të produkteve të konsumit bazë si rezultat i uljes së zinxhirit të kostos nëpërmjet uljes së detyrimit tatimor; (ii) zbutje e varfërisë nëpërmjet mbajtjes në kontroll të çmimeve të produkteve bazike të shportës ushqimore, duke u dhënë mundësi për jetesën shtresave të varfra dhe më specifikisht rreth 20% të popullsisë, që jeton me 1 USD për individ në ditë (gjysma e shpenzimeve të shqiptarëve kalon për mallrat e konsumit të përditshëm).

II. ARGUMENTIMI I AMENDAMENTIT LIDHUR ME PERPARESITE, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Çmimet e artikujve bazë të shportës, siaps të dhënave nga muaji mars e në vijim çmimet për zërin e “Ushqimeve dhe pijeve joalkoolike” janë rritur në mënyrë galopante ndërsa inflacioni ka ardhur në rritje duke kapur një record më të lartë se sa ai I viteve 1997. Një rritje e tillë që pritet të vijohet edhe në vitin e ardhshëm do të ndikojë edhe më shumë në rreth 40% të popullsisë dhe sidomos tek qytetarët që jetojnë me më pak se 5 USD/ditë. Sipas INSTAT, në vitin 2019 janë vlerësuar 659.000 individë që jetojnë nën kufirin e rrezikut për të qenë të varfër. Në kushtet e pandemisë, shtresat e varfëra u përballën me kostot më të larta dhe rritja e cmimeve do të përkeqësojë më shumë situatën financiare të kësaj shtrese.

Gjysma e shpenzimeve të familjeve shqiptare kanalizohet në blerjen e ushqimeve, ndërkohë, që çmimet e tyre janë përbërësit kryesorë të inflacionit në vend, parametër i mbajtur në kontroll nga Banka e Shqipërisë në nivelin 8,30% (Tetor 202q), një shifër që pritet të jetë në mbi 6% sipas aprashikimeve të fundit të IMF për vitin aktual.

Pjesëmarrja e shtetit në jetën ekonomike, si rregullator dhe mbikqyrës në sektorë prodhues dhe importues të produkteve ushqimore është me rëndësi jetike për mbijetesën/mirëqënien e popullatës. Vecanërisht në situatën e ngarkuar ekonomike me kufizimet e rritjes shkaktuar nga pandemia, shteti nëpërmjet mekanizmave të tij dhe jo tregu, ngelet rregullatori i vetëm në stabilizimin e cmimeve të produkteve ushqimore me rëndësi jetike.

Në vazhdim të sa më lart, pavarësisht nga diferenca e shkaktuar në buxhetin e shtetit nga arkëtimi i më pak të ardhurave nga TVSH e reduktuar nga 20 % në 6 %, buxheti (Ministria e Financave), duhet të konsiderojë modifikimet përkatëse dhe ndryshimin e volumit të zërave në investime / shpenzime qeveritare të gjykuara jo prioritare në raport me mbijetesën ushqimore të shqiptarëve dhe kohën në të cilën jetojmë. Kjo sjell gjithashtu një konkurrencë më të ndershme me vendet e rajonit, në përfrimin e vlerave mbi TVSH-në e produkteve ushqimore, ku përfitues janë bizneset dhe qytetarët / konsumatorët (Maqedoni e Veriut TVSH për shportën ushqimore 5%, Kosova 8%, Sërbia 8%).

Jo vetëm kaq por është një metodë që sjell më shumë të ardhura dhe më shumë mundësi për të përballuar çmimet e larta duke përdorur politikën fiskale si mekanizëm për të përballuar normën e lartë të inflacionit.

Përsa kohë që rritja e pagave dhe pensione nuk po ndodh prej shumë vitesh, është e detyrueshme reduktimi i TVSH-së për të frenuar rritjen e pandalshme të çmimeve të produkteve ushqimore bazë të shportës, pasi pagat nuk po ndjekin rritjen e çmimeve të mallrave.

Qeveria, në afatshkurtër do të përfitojë nga rritja e çmimeve, duke mbledhur më shumë taksa, të cilat ndikojnë në përmirësimin e deficitit fiskal dhe uljen e borxhit.

Reduktimi i TVSH-së nga 20 % në 6% për shportën e Ushqimeve dhe pijeve joalkoolike është një ndihmë më e madhe për familjet shqiptare të goditura nga kriza ekonomike dhe rritja e çmimeve. Ata janë një shtysë positive sidomos në parashikueshmërinë e FMN e cila parasheh një rritje shumë të ulët ekonomike në raport me rajonin për vitin e ardhshëm.

III. VLERESIMI I LIGJSHMERISE, KUSHTETUTSHMERISE DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NE FUQI VENDAS E NDERKOMBETAR

Amendamenti është propozim i një deputetije të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me nenin 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË AMENDAMENTIT

Amendamenti përbëhet nga një dispozitë, e cila sjell një shtesë në nenin 49 të ligjit nr. 92/2014, që ka të bëjë me shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar. Konkretisht, pika 11 e shtuar synon reduktimin e TVSH-së nga 20% në 6% për mallrat e shportës. Këto të fundit janë përcaktuar dhe përbëhen nga mielli, buka, vezët, qumështi, bulemti, patatja, vaji, sheqeri dhe mishi.

V. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ndikimet dhe implikimet buxhetore janë llogaritur, duke u referuar të dhënave statistikore nga INSTAT. Nga një vlerësim paraprak, në Shqipëri janë 768.963 mijë familje, me një buxhet familjar mesatar së shportës së ushqimit prej 83.475 mijë lek/familje (3.6 persona); nga këto konsumohen 16.200 mijë lek për shportën bazë të ushqimeve. Me uljen e TVSH-

së nga 20% në 6%, për shportën bazë ushqimore, buxheti i shtetit do ketë një rënie prej 17 miliardë lekë/në vit.

Propozohet, që për të përballuar vështirësitë ekonomike, të ulet TVSH-ja dhe efekti negativ prej 17 Mld lekë, të gjenden nga Programi i PPP-ve për vitin 2023, ose rialokimi i fondeve për shpenzime jo prioritare.

Jorida TABAKU

